



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:912661

Datë: 18.01.2021

Numri i dokumentit: 01415259

AC.nr.973/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Gëzim Lulluni kryetar, Nora Blaca-Dula dhe Halide Reka anëtarë, në çështjen juridike të paditëses Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, e përfaqësuar nga M.B., zyrtare e lartë nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme-Spektori ligjor, në AZHB-MBPZHR, kundër të paditurit T.K. nga Rahoveci, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i tij i autorizuar F.H., avokat nga Rahoveci, për shkak të pasurimit të pabazë, vlera e kontestit 900.00€, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr.218/2016 të dt. 25.10.2018, në seancën e kolegjit e mbajtur me dt.12.01.2021, mori këtë :

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e të paditëses, Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr.218/2016 i dt. 25.10.2018, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, refuzohet kërkesëpadia e paditëses me të cilën ka kërkuar që të “detyrohet i padituri T.K., Rr.”...” Komuna e Rahovecit, që shumën e mjeteve prej 900,00€, të i kthen në llogarinë rrjedhëse pranë BQK-së në emër të M.B.P.ZH.R. dhe atë në emër të pasurimit të pabazë, të tëra këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën përmbarimi do të behet me detyrim” si e pabazuar. Me të njëjtin aktgjykim, është vendosur që, secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur paditësja, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që ankesa të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe aktgjykimi i goditur të priset dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë, në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i të paditurit, me propozim që ankesa e përfaqësuesit të paditësit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet duke e detyruar paditësen, në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoj shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, ato të përgjigjes në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim me dispozitat e nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se: paditësja në gjykatën e shkallës së parë, paraqitur padi kundër të paditurit duke kërkuar pagesën e mjeteve prej 900.00€, në emër të pasurimit të pabazë. Ka theksuar se i padituri është subvencionuar për vreshtë për vitin 2015, në shumë prej 900.00€, për sipërfaqen prej 0.90.00ha, mirëpo, në kontrollin e bërë me dt.23.03.2016, është vërtetuar se fermeri nuk e ka të mbjellë sipërfaqen e vreshtit në teren, në sipërfaqen të cilën e ka deklaruar në aplikacion. Përfaqësuesja e paditëses, ka ngelë pranë kërkesëpadisë së paraqitur, duke theksuar se të gjithë fermerët kanë qenë të obliguar që të paraqesin ndryshimin e vreshtave në Departamentin e vreshtarisë. Para ngritjes së kërkesëpadisë, kemi kërkuar kthimin e mjeteve financiare vetëm për sipërfaqen e kontestuar, por i padituri nuk është përgjigjur. Ka kërkuar aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses.

Gjykata shkallës së parë, ka administruar provat dhe vlerësuar ato dhe në fund ka marrë aktgjykimin e atakuar, me të cilin e refuzuar kërkesëpadinë e paditëses, të përshkruar me decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar se pala e paditur T.K., për vitin prodhues 2015, ka aplikuar tek paditësja për subvencionimin në vreshtari, për vreshtë në sipërfaqe prej 0,90ha, në pajtim me Certifikatën e vreshtarit të lëshuar nga Departamenti për Vreshtari në Rahovec, për të cilën sipërfaqe është subvencionuar në shumë prej 900,00€. Faktin se i padituri si vreshtar në vitin 2015, e ka poseduar vreshtin në sipërfaqe prej 0.90.00ha dhe atë të varietetit Shardonit, në sipërfaqe prej 0.45.18ha dhe Kardinal Black Magic në sipërfaqe prej 0.44.37ha, është argumentuar me Certifikatën e vreshtarit të dt.13.05.2015, që ka qenë në aplikacionin e të paditurit me nr.20204 të dt.18.05.2015.

Ndërkaq, nga procesverbali i inspektorëve të bërë me dt.23.03.2016, vërtetohet se është gjetur dallimi i sipërfaqes prej 0.45.00ha dhe është verifikuar sipërfaqja prej 0.45.00ha, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 0.90.00ha. Pastaj, nga parashpresa e prezantuar nga përfaqësuesi i të paditurit, lidhur me lajmërimin e ndryshimit në vreshtë të dt.17.11.2015, është vërtetuar se i padituri e ka lajmëruar departamentin për vreshtari dhe verëtari në Rahovec, për shkulljen e vreshtit të varietetit Black Magic, me sipërfaqe prej 0.44.00ha.

Gjykata e shkallës së parë në rastin e vendosjes në këtë çështje juridike, ka marrë për bazë faktin se i padituri në vitin 2015, ka aplikuar për sipërfaqe të mbjellur me vreshtë prej 0.90.00ha, të cilën e ka poseduar të mbjellur me vreshtë dhe për këtë sipërfaqe është subvencionuar, të cilat janë argumentuar me prova në shkresat e lëndës.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar dhe faktin se të paditurit në vitin 2015, nuk i ka munguar sipërfaqja prej 0.45,00ha, siç ceket në padi, ndërsa i padituri me dt.17.11.2015, e ka lajmëruar Departamentin për vreshtari në Rahovec, për shkuljen e vreshtit dhe gjykata ka konstatuar se me veprimet e të paditurit nuk ka elemente për begatim të pabazë në dëm të paditëses. Në anën tjetër pretendimet e paditëses, gjykata i ka konsideruar të pa argumentuara.

Këtë gjendje faktike të çështjes gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në dispozitat e nenit 194 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, si dhe në dispozitat e neneve 143, 319 dh 450 të LPK-së dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar faktin se i padituri i ka përfillur të gjitha procedurat ligjore, duke e lajmëruar paditësen për shkuljen e një pjesë të vreshtës së tij në sipërfaqen prej 0.44 ha. Po ashtu edhe kjo gjykatë vlerëson se, i padituri i ka përfillur dispozitat e nenit 9 par.2 të Ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Ligji nr.03/L-098), dhe se si përfitues i subvencioneve i ka përdorë fondet në përputhje me qëllimin për të cilin edhe janë dhënë subvencionet për vitin kalendarik 2015, se i padituri ndryshimet i ka paraqitur me kohë për shkuljen e vreshtit në sipërfaqen prej 0.44 ha, ashtu që në këtë rast nuk vjen në shprehje zbatimi i nenit 38A, i Ligjit nr. 04/L-090, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Ligji nr.03/L-098), pasi që i padituri nuk ka pasur kurrfarë parregullsie që ndaj tij të merren masat ndëshkuese. Pra nga të cekurat vërtetohet pa mëdyshje se nuk ka ardhur deri te zmadhimi i pasurisë së të paditurit, e nga ana tjetër zvogëlim i pasurisë së paditëses. Kështu që pretendimi ankimor në këtë aspekt, u refuzua si i pa bazuar nga kjo gjykatë.

Pra, nuk qëndron pretendimi ankimor se, janë shkelur dispozitat ligjore dhe nënligjore për dhënie e subvencioneve. Mirëpo, Gjykata e Apelit lidhur me këtë çështje vlerëson se, fermeri në rastin konkret i padituri T.K., nuk ka shkelur dispozitat e pretenduara ligjore nga paditësja sepse siç ka vërtetuar edhe gjykata e shkallës së parë, certifikata e vreshtit të fermerit është e vitit 2015 dhe ka të regjistruar sipërfaqen e vreshtit prej 0.90ha dhe kjo ka ndodhur në kohën kur i padituri ka aplikuar për subvencione, dhe se kjo sipërfaqe ka qenë deri kur i padituri e ka vjelë rrushin për atë vit kalendarik, ashtu që në mesin e muajit nëntor të atij viti një pjesë të veshhtës në sipërfaqen e ceku më lartë e ka shkukur, sepse viti i prodhimit ka përfunduar.

Ashtu siç ka vlerësuar edhe gjykata e shkallës së parë, qëndrimin juridik të saj lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, për faktin se i padituri në cilësi të vreshtarit ka aplikuar për subvencione për vitin 2015 dhe nga paditësja është kompensuar në shumën prej 900,00€. Siç rezulton nga shkresat e lëndës, në kohën e aplikimit për subvencione i padituri e ka pasur të mbjell me vreshtë sipërfaqen prej 0.90ha dhe për këtë sipërfaqe edhe është subvencionuar.

Nga shkresat e lëndës qartë shihet se, i padituri e ka lajmëruar ndryshimin në vreshtë tek departamenti përkatës për vreshtari dhe verëtarin në Rahovec dhe atë me dt.17.11.2015, që e

argumenton edhe formulari i lajmërimit të ndryshimeve i nënshkruar nga fermeri, tani i paditur dhe personi zyrtar i paditëses.

Në formularin në fjalë nga ana e të paditurit është cekur se janë shkukur 0.44ha me dt. 17.11.2015. Pra, siç shihet i padituri e ka lajmëruar ndryshimin në sipërfaqen e vreshtës në kohën kur e ka shkukur një pjesë të saj, e që ka qenë muaji Nëntor i vitit 2015, në të cilin muaj vreshta veç e ka të përfunduar prodhimin e saj, ndërsa rrushi është i vjelur.

Konstatimi i inspektorëve të paditëses, për gjendjen ekzistuese në teren tek me dt.23.03.2016, në situatën ekzistuese është fakt irelevant i cili nuk ka ndonjë ndikim në gjendjen ekzistuese të vitit 2015, për të cilin vit paditësja e ka subvencionuar të paditurin. Do të ishte krejt në rregull sikur inspektorët e paditëses të bënin daljen në vend shikim dhe konstatimin e gjendjes gjatë vitit 2015, për të cilin edhe janë dhënë subvencionet dhe sikur i padituri të kishte kryer veprimin e tillë gjatë fazës kur ekziston prodhimitaria e vreshtës, atëherë, do të kishte rezultuar se i padituri vërtetë i ka shkukur dispozitat e Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural dhe normalisht se është dashur që shumën e marrë në emër të subvencionimit edhe ta kthej. Pra, në situatën konkrete nga paditësja në ankesën e saj nuk është argumentuar me asnjë provë se i padituri ka bërë ndonjë parregullsi gjatë vitit 2015 dhe ka shkukur dispozitat ligjore të pretenduara nga paditësja.

Edhe sa i përket shkresës së paditëses të dt.29.10.2018, nga shkresat e bashkangjitura kësaj shkrese të paditëses nuk rezultojnë se është bërë ndonjë vulosje e mëvonshme e formularit të njoftimit për ndryshimet në sipërfaqen e kontestuar, por edhe sikur të kenë ndodhur këto, atëherë, kjo nuk mund të jetë përgjegjësi e të paditurit, sepse në nënshkrimin e formularit të ndryshimit në vreshtë është i cekur përpos të paditurit T.K. edhe personi zyrtar T.B., me nënshkrimin e dhënë. Kështu që pretendimi ankimor në këtë aspekt, nuk pati ndonjë ndikim relevant në aktgjykimin e atakuar për të ndryshuar të njëjtin apo për ta prishur atë, siç pretendohet në ankesën e paraqitur.

Nga gjithë kjo që u theksua më sipër, sipas Gjykatës së Apelit, nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i atakuar është rrjedhojë e konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, sepse gjykata e shkallës së parë duke pasur në dispozicion të gjitha provat e ofruara nga palët ndërgjyqëse, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike duke filluar nga aplikimi i të paditurit për subvencione tek paditësja, pastaj realizimi i atij subvencioni në shumë prej 900,00€, nga i padituri e më pas edhe lajmërimi i të paditurit tek paditësja lidhur me ndryshimet të cilat janë bërë në sipërfaqen e vreshtës, e cila ka qenë e mbjellur gjatë vitit 2015. Prandaj, kjo gjykatë vlerëson se, duke qenë se plotësisht dhe drejtë është konstatuar gjendja faktike dhe se në këtë gjendje faktike të vërtetuar drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, kur gjykata në aktgjykimin e atakuar drejtë i referohet dispozitave përkatëse ligjore të cilat aplikohen në situata të tilla, si kjo e paditëses.

Aktgjykimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm, ndërsa kërkesëpadia e paditëses për kthimin e subvencionit të realizuar nga i padituri për vitin 2015, duke e konsideruar këtë edhe si pasurim i pabazë nuk ka mbështetje në provat e argumentuara dhe në ligj.

Me dispozitën e nenit 194 par.1 të LMD-së, në mënyrë eksplicite parashihet se " *secili person që pasurohet pabazë ligjore në dëm të një tjetrit është i detyruar të kthej atë që ka marrë nga tjetri ose ndryshe të kompensoj vlerën e fitimit të arritur*". Mirëpo në rastin konkret, i padituri nuk është pasuruar pa bazë ligjore sepse me dokumentacion valid ka realizuar subvencionin nga paditësja dhe i cili subvencion i referohet vitit 2015, ndërsa konstatimet e

inspektorëve të paditëses me dt.23.03.2016, për gjendjen në teren në vreshtën e të paditurit janë të vonshme, sepse ato kanë mund të konstatohen gjatë vitit për të cilin i padituri është subvencionuar, përkatësisht, vitit 2015.

Ndërkaq me dispozitën e nenit 319 par.1 të LPK-së, parashihet se “*secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*”. Mirëpo në situatën konkrete, paditësja nuk ka arritur që të argumentoj me prova gjatë procedurës së zhvilluar në shkallë të parë e as në procedurën ankimore në shkallë të dytë, kërkesëpadinë e saj.

Sipas Gjykatës së Apelit, përgjithësisht pretendimet ankimore të të paditëses, ishin të pa bazuara, pa mbështetje në prova konkrete dhe të cilat nuk ndikojnë në marrjen e vendimit ndryshe nga ai të cilin e ka marrë gjykata e shkallës së parë..

Prandaj, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, në tërësi e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e pajtim me dispozitat e nenit 195 par. 1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.973/2019, me dt.12.01.2021

Kryetari i kolegjit-gjykatësi
Gëzim Lulluni